



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/59

Datë: 17.11.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 Nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të Modernizimit të Shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/59

Datë: 17.11.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 Nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Zëvendëskryeministrave, Ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zëvendësministrave, si dhe Drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), u njihet e drejta e pagës pas mbarimit të mandatit të tyre, si në vijim:
 - 1.1. Zëvendëskryeministrave, Ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Drejtorit të AKI-së u njihet e drejta e pagës për një vit pas mbarimit të mandatit të tyre;
 - 1.2. Zëvendësministrave u njihet e drejta e pagës për 6 muaj pas mbarimit të mandatit të tyre;
2. Paga e ish-zëvendëskryeministrave, ish-ministrave, ish-zëvendësministrave dhe ish-drejtorit të AKI-së, do të jetë në vlerë të 70% të pagës së plotë që kanë marrë gjatë muajit të fundit të mandatit të tyre.
3. Të lartshënuarit sipas pikës 1. të këtij vendimi, e gëzojnë këtë të drejtë, vetëm nëse nuk marrin të ardhura nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
4. Pagesa bëhet nga institucionet ku kanë ushtruar detyrat të lartshënuarit, nga dita që vendimi hyn në fuqi.
5. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë nr. 7/135 i datës 1 mars 2005 dhe Vendimi nr. 05/276 i datës 17 tetor 2007.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/59

Datë: 17.11.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet me sugjerime Koncept-dokumenti për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/59

Datë: 17.11.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 Nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Përcaktohet lartësia e pagesës së shumës mujore për ndihmë sociale, sipas numrit të anëtarëve dhe vlerës së pikëve.
2. Vlera e një (1) pike është e barabartë me një euro e njëzetepesë cent (1.25) euro.
3. Bazuar në numrin e anëtarëve dhe numrin e pikëve që ka familja në Skemën e Ndihmës Sociale, shuma mujore e pagesës për ndihmë sociale për një familje do të jetë si vijon:

Familja me;	Numri i Pikëve	Shuma në Euro
Një (1) anëtar	40	50.00
Dy (2) anëtarë	55	68.75
Tre (3) anëtarë	60	75.00
Katër (4) anëtarë	65	81.25
Pesë (5) anëtarë	70	87.50
Gjashtë (6) anëtarë	75	93.75
Shtatë (7) anëtarë	80	100.00
Tetë (8) anëtarë	85	106.25
Nëntë (9) anëtarë	90	112.50
Dhjetë (10) anëtarë	95	118.75

Njëmbëdhjetë (11) anëtarë	100	125.00
Dymbëdhjetë(12) anëtarë	105	131.25
Trembëdhjetë (13) anëtarë	110	137.50
Katërmëdhjetë (14) anëtarë	115	143.75
Pesëmbëdhjetë (15) anëtarë	120	150.00

4. Familjet që kanë më shumë se pesëmbëdhjetë (15) anëtarë, për çdo anëtarë shtesë marrin nga pesë (5) pikë në vlerën e euros për një (1) pikë, siç është përcaktuar në paragrafin 2. të këtij vendimi.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të zbatohet nga muaji nëntor 2015.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë